



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. **54**

Prishtinë, më 29.9.2009, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: **Lulzim Zeneli**, **Naim Maloku**, **Myrvete Pantina**, **Heset Cakolli**, **Berat Luzha**, **Selvie Halimi**.

Munguan : **Zef Morina**, **Dragiša Mirić**, **Ali Lajçi**, **Elheme Hetemi** dhe **Zulfi Merxha**,

Të ftuarit dhe pjesëmarrësit tjerë : vëzhgues të interesuar .

Nga stafi mbështetës i komisionit : **Bajram Badivuku**, **Kujtim Aliu**.

Mbledhjen e kryesoi **Lulzim Zeneli**, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i projektligjit për ndryshimin e ligjit për Pyjet,
3. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes, hapi mbledhjen për pikat e rendit të ditës.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Lulzim Zeneli konstatoi miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

2. Shqyrtimi i projektligjit për ndryshimin e ligjit për Pyjet

Lulzim Zeneli kërkoi sqarimin nga **Berat Luzha** lidhur me grupin punues rreth projektligjit.

Berat Luzha njoftoi se projektligji është duke u shqyrtuar në grupin punues ndërsa që të premtën ndoshta do të përfundoj shqyrtimi.

Naim Maloku mbështeti grupin punues duke konstatuar se kemi të bëjmë me një projekt mjaft të koklavitur, ai sugjeroi që pas grupit punues në komision të harmonizohen qëndrimet.

Lulzim Zeneli gjithashtu kërkoi njoftimin për grupin tjetër punues rreth ndotjes së ajrit, ndërsa **Selvie Halimi** njoftoi se puna shpejt do të përfundojë edhe rreth këtij projekti.

3. Të ndryshme

Lulzim Zeneli njoftoi komisionin rreth projektligjit për Rrezatimin Jonizues i cili gjendet në ambasadën Amerikane, përkatësisht tek zyra ligjore. Ai tha se ka marr njoftimin gojor nga zyrtarët amerikan që projektligji mund të procedohet me amendamente ashtu si është, dmth nuk kanë asgjë shtesë.

Naim Maloku shprehu mirëseardhjen e tij lidhur me këtë fakt, ngase siç tha ai projektligji është punuar mjaft mirë në komision, ndaj propozoi që të caktohet për sot dy javë më 13.10.2009 duke ftuar edhe përfaqësuesin e zyrës ligjore të MMPH.

Komisioni u pajtua me këtë sugjerim.

Lulzim Zeneli parashtrroi një tjetër çështje lidhur me organizimin e një konference rajonale për çështje mjedisore në fund të nëntorit ose në fillim të dhjetorit, në bashkëpunim me OSCE. Fundi i vitit, vazhdoi, me siguri i përshtatet edhe shteteve të rajonit, përfaqësuesit e të cilëve do të ftohen. Ai kërkoi mendimin e komisionit pasi që ky komision do të propozoi pjesën organizative në mbështetje të OSCE.

Naim Maloku propozoi vendin “Sharr” përtej Prevallës si vendmbajtjen e konferencës.

Lulzim Zeneli tha se do të bisedohet në atë takim të veçantë.

Komisioni nxori :

K O N K L U D I M

1. Komisioni do të shqyrtoi në një takim të veçantë organizimin e konferencës rajonale me mbështetje nga OSCE në fund të nëntorit ose në fillim të dhjetorit 2009.

2. Në këtë takim do të sugjerohen mysafirët dhe vendi i mbajtjes së konferencës.

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 13,30, mbledhja e radhës do të mbahet më 6.10.2009 ku do të ftohet ministri i MMPH dhe do të shqyrtohen propozimet për pyje nëse përfundon GP punën deri atëherë, ndërkaq për sot dy javë projektligji për Rrezatimin Jonizues.

Kryetari i Komisionit,
Lulzim Zeneli